

VENDIM
Nr. 551, datë 18.6.2015

**PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE PËR PAJISJEN ME
CERTIFIKATËN E LEJES PROFESIONALE PËR VEPRIMTARITË STUDIMORE-
PROJEKTUESE DHE ZBATUESE PËR KËRKIMIN, PRODHIMIN, PËRPUNIMIN,
TRANSPORTIMIN, DEPOZITIMIN DHE TREGTIMIN E LËNDËVE
HIDROKARBURE**

(ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 509, datë 17.7.2019)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 4, të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve dhe të procedurave për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale për veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese për kërkimin, prodhimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e lëndëve hidrokarbure.

2. Specialisti që kërkon të ushtrojë veprimtari studimore-projektuese në fushën hidrokarbure për veprimtaritë e kërkimit, prodhimit, përpunimit, transportimit, depozitimit dhe tregtimit të lëndëve hidrokarbure, përfshirë ndërtimin e instalimeve teknologjike dhe impianteve të nevojshme për shpimin e puseve, prodhimin, depozitimin, përpunimin, transportimin dhe tregtimin e këtyre lëndëve, duhet të pajiset me certifikatën e lejes profesionale përkatëse.

3. Specialisti që kërkon të ushtrojë veprimtari zbatuese në fushën hidrokarbure për konsulencën, mbikëqyrjen, kolaudimin, monitorimin dhe drejtimin teknik në veprimtaritë e kërkimit, prodhimit, përpunimit, transportimit, depozitimit, tregtimit të burimeve dhe lëndëve hidrokarbure, përfshirë ndërtimin e instalimeve teknologjike dhe impianteve të nevojshme për shpimin e puseve, prodhimin, depozitimin, përpunimin, transportimin dhe tregtimin e këtyre lëndëve, duhet të pajiset me certifikatën e lejes profesionale përkatëse.

4. Specialistët pajisen me certifikatën e lejes profesionale në fushën e veprimtarisë hidrokarbure të kërkimit, prodhimit, përpunimit, transportimit të burimeve dhe lëndëve hidrokarbure, përfshirë ndërtimin dhe shfrytëzimin e instalimeve teknologjike dhe impianteve të nevojshme për shpimin e puseve, prodhimin, depozitimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e këtyre lëndëve, si studiues-projektues, konsulent, mbikëqyrës, kolaudues, monitorues dhe drejtues teknik, mbi bazën e kriterëve që kanë të bëjnë me aftësitë tekniko-profesionale dhe me periudhën kohore të angazhimit të tyre në veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese në këtë fushë.

5. Pajisja me certifikatën e lejes profesionale e specialistëve, vendas dhe të huaj, për veprimtari studimore-projektuese dhe /ose zbatuese, bëhet nga ministri përgjegjës për hidrokarburet mbi bazën e vendimit të komisionit të vlerësimit për plotësimin e kriterëve të pajisjes me certifikatë, i cili ngrihet pranë ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

6. *Personi juridik ose fizik, për të ushtruar veprimtarinë studimore-projektuese dhe/ose zbatuese në fushën e veprimtarisë hidrokarbure, duhet ta ketë të regjistruar si objekt, në regjistrin tregtar, kryerjen e kësaj veprimtarie.*

7. *Shfuqizuar.*

8. *Personi juridik ose fizik, i regjistruar paraprakisht në regjistrin tregtar, që ushtron veprimtarinë studimore-projektuese dhe/ose zbatuese në fushën e veprimtarisë hidrokarbure, duhet të ketë të punësuar specialistë, të cilët të jenë të pajisur me certifikatë, sipas kategorisë përkatëse, për veprimtari studimore-projektuese dhe/ose zbatuese në fushën e veprimtarisë hidrokarbure.*

9. Tipat e certifikatave të lejeve profesionale, kriteret që duhet të plotësohen nga specialistët që kanë të drejtën të pajisen me certifikatën e lejes profesionale për veprimtari studimore-projektuese

dhe/ose zbatuese në fushën hidrokarbure, si dhe dokumentet vërtetuese përkatëse përcaktohen në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

10. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të komisionit të vlerësimit dhe procedurat e vlerësimit të dokumenteve për dhënien e certifikatave të lejeve profesionale, për kryerjen e veprimtarisë studimore-projektuese dhe/ose zbatuese në fushën e veprimtarisë hidrokarbure përcaktohen në aneksin 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

11. Ministri përgjegjës për hidrokarburet përcakton anëtarët e komisionit të vlerësimit për plotësimin e kriterëve të pajisjes me certifikatën e lejes profesionale, për veprimtari studimore-projektuese dhe/ose zbatuese në fushën e veprimtarive të sektorit hidrokarbur.

12. Për evidentimin e specialistëve të pajisur me certifikatën e lejes profesionale për veprimtari studimore-projektuese dhe/ose zbatuese në fushën e veprimtarive të sektorit hidrokarbur, në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet krijohet regjistri shtetëror i specialistëve të certifikuar, sipas rregullave të miratuara nga ministri.

Regjistri është i disponueshëm për publikun, sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e administrimit të tij, që miratohet nga ministri përgjegjës për hidrokarburet.

13. Ndaj refuzimit të kërkesës për t'u pajisur me certifikatën e lejes profesionale, pala e interesuar mund të ankohet në rrugë administrative dhe, më pas, në gjykatë, brenda afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

14. Kur specialisti i pajisur me certifikatën e lejes profesionale emërohet në administratën publike, në një detyrë që mbart konflikt interesash, kjo certifikatë nuk përdoret prej tij për aq kohë sa është në atë detyrë.

15. Për shqyrtimin e kërkesës, aplikuesi paguan tarifën e shërbimit, në shumën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, e cila paguhet me dorëzimin e kërkesës dhe është e pakthyeshme edhe nëse kërkesa nuk miratohet. Të ardhurat nga tarifat derdhen në buxhetin e shtetit.

16. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

ANEKSI 1

Dokumentet vërtetuese për plotësimin e kriterëve nga specialistët që aplikojnë për pajisjen me certifikatë të lejes profesionale për veprimtarinë studimore-projektuese dhe/ose zbatuese në fushat e sektorit të lëndëve hidrokarbure janë, si më poshtë vijon:

A. Për veprimtarinë studimore-projektuese dhe zbatuese në aktivitetin e kërkimit dhe prodhimit të lëndëve hidrokarbure:

1. Certifikata e lejes profesionale si studiues-projektues, mbikëqyrës, monitorues për aktivitetin e kërkimit të lëndëve hidrokarbure

Aplikuesi, për këtë certifikatë, duhet të paraqesë në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet dokumentet e mëposhtme:

a) Kërkesën për kategorinë e certifikatës;

b) Fotokopje të noterizuara të diplomës universitare ose pasuniversitare dhe listës së notave për inxhinier gjeolog dhe disiplinat përkatëse, inxhinier shpimi pusesh hidrokarbure, inxhinier burimesh energjetike, inxhinier gjeofizik, fizikan, informaticien, matematicien, ekonomist dhe/ose inxhinier përpunimi kompjuterik të informacionit gjeofizik dhe gjeologjik, inxhinier mekanik industri, inxhinier mjedisi për energjetikë. Për këtë certifikatë të lejes profesionale pranohet niveli master i studimeve universitare, në përputhje me ligjin e arsimit të lartë;

c) Fotokopje të noterizuar të librezës së punës (ose ndonjë dokument tjetër zyrtar i lëshuar nga organi kompetent), ku vërtetohet se ka një eksperiencë jo më pak se 5 (pesë) vjet në fushën e veprimtarisë së kërkimit të lëndëve hidrokarbure;

ç) Një përshkrim të aktivitetit të tij në fushën e kërkimit të burimeve hidrokarbure, në formë autobiografie teknike (*Curriculum-Vitae*), vërtetuar sipas dokumentacionit nga institucionet përkatëse, universiteti, punëdhënësi, nëse ka qenë i punësuar;

d) Certifikata për kualifikimet apo specializimet, të lëshuara nga organet kompetente, në rast se ka;

dh) Dy fotografi në format dokumenti;

e) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale.

2. Certifikata e lejes profesionale si projektues, konsulent, kolaudues për aktivitetin e kërkimit të lëndëve hidrokarbure

Aplikuesi, për këtë certifikatë, duhet të paraqesë në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet:

a) Kërkesën për kategorinë e certifikatës;

b) Fotokopje të noterizuara të diplomës universitare ose pasuniversitare dhe listës së notave. Aplikuesi duhet të jetë i diplomuar si: inxhinier gjeolog dhe disiplinat përkatëse, inxhinier shpimi pusesh hidrokarbure, inxhinier burimesh energjetike, inxhinier gjeofizik, fizikan, informaticien, matematicien, ekonomist dhe/ose inxhinier për punimi kompjuterik të informacionit gjeofizik dhe gjeologjik, inxhinier mekanik industri, ing. mjedisi për energjetikë. Për këtë certifikatë të lejes profesionale pranohet niveli master i studimeve universitare, në përputhje me ligjin e arsimit të lartë;

c) Fotokopje të noterizuar të librezës së punës (ose ndonjë dokument tjetër zyrtar i lëshuar nga organi kompetent), ku vërtetohet se ka një eksperiencë jo më pak se 5 (pesë) vjet në fushën e veprimtarisë së kërkimit të lëndëve hidrokarbure;

ç) Një përshkrim të aktivitetit të tij studimor dhe projektues në fushën e kërkimit të burimeve hidrokarburederi në momentin e kërkesës, në formë autobiografie teknike (*Curriculum-Vitae*), vërtetuar sipas dokumentacionit nga institucionet përkatëse, punëdhënësi, nëse ka qenë i punësuar;

d) Referenca nga vetë aplikuesi apo persona fizikë/juridikë për objekte të studiuar, projektuar/zbatuar në jo më pak se 3 (tre) të tilla;

dh) Certifikata për kualifikimet apo specializimet dhe kontributet e veçanta, të lëshuara nga organet kompetente, në rast se ka;

e) Jo më pak se 2 (dy) referenca vlerësuese të aktivitetit të tij në fushën e kërkimit të lëndëve hidrokarbure;

ë) Dy fotografi në format dokumenti;

f) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale.

3. Certifikata e lejes profesionale si studiues-projektues, mbikëqyrës, monitorues për prodhimin dhe zhvillimin e lëndëve hidrokarbure.

Aplikuesi, për këtë certifikatë, duhet të paraqesë në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet dokumentet e mëposhtme:

a) Kërkesën për kategorinë e certifikatës;

b) Fotokopje të noterizuara të diplomës universitare ose pasuniversitare dhe listës së notave. Aplikuesi duhet të jetë i diplomuar si inxhinier teknolog prodhimi, inxhinier gjeolog dhe disiplinat përkatëse, inxhinier shpimi pusesh hidrokarbure, inxhinier burimesh energjetike, inxhinier gjeofizik, fizikan, informaticien, matematicien dhe/ose inxhinier përpunim kompjuterik të informacionit gjeofizik dhe gjeologjik, ekonomist energjetik, inxhinier mekanik industri, inxhinier mjedisi për energjetikë. Për këtë certifikatë të lejes profesionale pranohet niveli master i studimeve universitare, në përputhje me ligjin e arsimit të lartë;

c) Fotokopje të noterizuar të librezës së punës (ose ndonjë dokument tjetër zyrtar i lëshuar nga organi kompetent), ku vërtetohet se ka një eksperiencë jo më pak se 5 (pesë) vjet në fushën e prodhimit dhe zhvillimit të lëndëve hidrokarbure;

ç) Një përshkrim të aktivitetit të tij në fushën e prodhimit dhe zhvillimit të lëndëve hidrokarbure, në formë autobiografie teknike (*Curriculum-Vitae*), vërtetuar sipas dokumentacionit nga institucionet përkatëse, universiteti, punëdhënësi, nëse ka qenë punësuar;

d) Certifikata për kualifikimet apo specializimet, të lëshuara nga organet përkatëse, në rast se ka;

dh) Dy fotografi në format dokumenti;

e) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale.

4. Certifikata e lejes profesionale si projektues, konsulent, kolaudues për prodhimin dhe zhvillimin e lëndëve hidrokarbure

Aplikuesi, për këtë certifikatë, duhet të paraqesë në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet:

a) Kërkesën për kategorinë e certifikatës;

b) Fotokopje të noterizuara të diplomës universitare ose pasuniversitare dhe listës së notave për inxhinier teknolog prodhimi, inxhinier gjeolog dhe disiplina të përkatëse, inxhinier shpimi pusesh hidrokarbure, inxhinier burimesh energjetike, inxhinier gjeofizik, fizikan, informaticien, matematicien dhe/ose inxhinier përpunimi kompjuterik të informacionit gjeofizik dhe gjeologjik, ekonomist energjetik, inxhinier mekanik industri, inxhinier mjedisi për energjetikë. Për këtë certifikatë të lejes profesionale pranohet niveli master i studimeve universitare, në përputhje me ligjin e arsimit të lartë;

c) Fotokopje të noterizuar të librezës së punës, ku vërtetohet se ka një eksperiencë jo më pak se 5 (pesë) vjet në fushën e veprimtarisë së prodhimit dhe zhvillimit të lëndëve hidrokarbure;

ç) Një përshkrim të aktivitetit të tij studimor dhe projektues në fushën e prodhimit dhe zhvillimit të lëndëve hidrokarbure deri në momentin e kërkesës, në formë autobiografie teknike (*Curriculum-Vitae*), vërtetuar sipas dokumentacionit nga institucionet përkatëse, punëdhënësi;

d) Referenca nga vetë aplikuesi apo persona fizikë/juridikë për objekte të studiuara, projektuar/zbatuar në jo më pak se 3 (tre) të tilla;

dh) Certifikata për kualifikimet apo specializimet dhe kontributet e veçanta, të lëshuara nga organet kompetente, në rast se ka;

e) Jo më pak se 2 (dy) referenca vlerësuese të aktivitetit të tij në fushën e prodhimit dhe zhvillimit të lëndëve hidrokarbure;

ë) Dy fotografi në format dokumenti;

f) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale.

5. Certifikata e lejes profesionale si drejtues teknik për aktivitetin e kërkimit, prodhimit e zhvillimit të lëndëve hidrokarbure

Aplikuesi, për këtë certifikatë, duhet të paraqesë në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet dokumentet e mëposhtme:

a) Kërkesën për kategorinë e certifikatës;

b) Fotokopje të noterizuara të diplomës universitare ose pasuniversitare dhe listës së notave për inxhinier teknolog prodhimi, inxhinier gjeolog dhe disiplina të përkatëse, inxhinier shpimi pusesh hidrokarbure, inxhinier burimesh energjetike, inxhinier gjeofizik, fizikan, informaticien, matematicien dhe/ose inxhinier përpunimi kompjuterik të informacionit gjeofizik dhe gjeologjik, ekonomist energjetik, inxhinier mekanik industri, inxhinier mjedisi për energjetikë. Për këtë certifikatë të lejes profesionale pranohet niveli master i studimeve universitare, në përputhje me ligjin e arsimit të lartë;

c) Fotokopje të noterizuar të librezës së punës, ku vërtetohet se ka një eksperiencë jo më pak se 5 (pesë) vjet në fushën e kërkimit, prodhimit e zhvillimit të lëndëve hidrokarbure;

ç) Një përshkrim të aktivitetit të tij në fushën e kërkimit, prodhimit e zhvillimit të lëndëve hidrokarbure nga marrja e diplomës deri në momentin e kërkesës, në formë autobiografie teknike (*Curriculum-Vitae*), vërtetuar sipas dokumentacionit nga institucionet përkatëse, punëdhënësi;

d) Referenca nga vetë aplikuesi apo persona fizikë/juridikë për kryerje dhe/ose zbatim projektsh të veprimtarive të kërkimit, prodhimit e zhvillimit të lëndëve hidrokarbure;

dh) Certifikata për kualifikimet apo specializimet dhe kontributet e veçanta, të lëshuara nga organet përkatëse, në rast se ka;

e) Jo më pak se 2 (dy) referenca vlerësuese të aktivitetit të tij në fushën e kërkimit, prodhimit e zhvillimit të lëndëve hidrokarbure;

ë) Dy fotografi në format dokumenti;

f) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale.

B. Për veprimtarinë studimore–projektuese dhe zbatuese në aktivitetin e përpunimit, transportimit, depozitimit dhe tregtimit të lëndëve hidrokarbure:

1. Certifikata e lejes profesionale si studiues-projektues, mbikëqyrës, monitorues për aktivitetin e përpunimit të lëndëve hidrokarbure

Aplikuesi, për këtë certifikatë, duhet të paraqesë në ministrinë përgjegjëse për hidro-karburet:

a) Kërkesën për kategorinë e certifikatës;

b) Fotokopje të noterizuara të diplomës universitare ose pasuniversitare dhe listës së notave. Aplikuesi duhet të jetë i diplomuar për inxhinier kimist teknolog naftë, inxhinier mekanik industri, inxhinier elektrik industri, inxhinier burimesh energjetike, fizikan, informaticien, matematicien dhe/ose inxhinier përpunimi kompjuterik të informacionit, ekonomist energjetik, inxhinier mjedisi për energjetikë. Për këtë certifikatë të lejes profesionale pranohet niveli master i studimeve universitare, në përputhje me ligjin e arsimit të lartë;

c) Fotokopje të noterizuar të librezës së punës, ku vërtetohet se ka një eksperiencë jo më pak se 5 (pesë) vjet në fushën e përpunimit të lëndëve hidrokarbure;

ç) Një përshkrim të aktivitetit të tij në fushën e përpunimit të lëndëve hidrokarbure, në formë autobiografie teknike (*Curriculum-Vitae*), vërtetuar sipas dokumentacionit nga institucionet përkatëse universiteti, punëdhënësi, nëse ka;

d) Certifikata për kualifikimet apo specializimet, të lëshuara nga organet përkatëse, në rast se ka;

dh) Dy fotografi në format dokumenti;

e) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale.

2. Certifikata e lejes profesionale si projektues, konsulent, kolaudues për aktivitetin e përpunimit të lëndëve hidrokarbure

Aplikuesi, për këtë certifikatë, duhet të paraqesë në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet dokumentet e mëposhtme:

a) Kërkesën për kategorinë e certifikatës;

b) Fotokopje të noterizuar të diplomës universitare ose pasuniversitare dhe listës së notave. Aplikuesi duhet të jetë i diplomuar si inxhinier kimist teknolog naftë, inxhinier mekanik industri, inxhinier elektrik industri, inxhinier burimesh energjetike, fizikan, informaticien, matematicien dhe/ose inxhinier përpunimi kompjuterik të informacionit, ekonomist energjetik, inxhinier mjedisi për energjetikë. Për këtë certifikatë të lejes profesionale pranohet niveli master i studimeve universitare, në përputhje me ligjin e arsimit të lartë;

c) Fotokopje të noterizuar të librezës së punës, ku vërtetohet se ka një eksperiencë jo më pak se 5 (pesë) vjet në fushën e veprimtarisë së përpunimit të lëndëve hidrokarbure;

ç) Një përshkrim të aktivitetit të tij studimor dhe projektues në fushën e përpunimit të lëndëve

hidrokarbure nga marrja e diplomës deri në momentin e kërkesës, në formë autobiografie teknike (*Curriculum-Vitae*), vërtetuar sipas dokumentacionit nga institucionet përkatëse, punëdhënësi;

d) Referenca nga vetë aplikuesi apo persona fizikë/juridikë për objekte të studiuara, projektuar/zbatuara;

dh) Certifikata për kualifikimet apo specializimet dhe kontributet e veçanta, të lëshuara nga organet përkatëse, në rast se ka;

e) Jo më pak se 2 (dy) referenca vlerësuese të aktivitetit të tij në fushën e përpunimit të lëndëve hidrokarbure;

ë) Dy fotografi në format dokumenti;

f) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale.

3. Certifikata e lejes profesionale si studiues-projektues, mbikëqyrës, monitorues për aktivitetin e transportimit, depozitimit dhe tregtimit të lëndëve hidrokarbure

Aplikuesi, për këtë certifikatë, duhet të paraqesë në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet:

a) Kërkesën për kategorinë e certifikatës;

b) Fotokopje të noterizuara të diplomës universitare ose pasuniversitare dhe listës së notave. Aplikuesi duhet të jetë i diplomuar si inxhinier kimist teknolog nafte, inxhinier mekanik industri, inxhinier elektrik industri, inxhinier burimesh energjetike, fizikan, informaticien, matematicien dhe/ose inxhinier përpunimi kompjuterik të informacionit, ekonomist energjetik, inxhinier mjedisi për energjetikë. Për këtë certifikatë të lejes profesionale pranohet niveli master i studimeve universitare, në përputhje me ligjin e arsimit të lartë;

c) Fotokopje të noterizuar të librezës së punës, ku vërtetohet se ka një eksperiencë jo më pak se 5 (pesë) vjet në fushën e transportimit, depozitimit dhe tregtimit të lëndëve hidrokarbure;

ç) Një përshkrim të aktivitetit të tij në fushën e transportimit, depozitimit dhe tregtimit të lëndëve hidrokarbure në formë autobiografie teknike (*Curriculum-Vitae*), vërtetuar sipas dokumentacionit nga institucionet përkatëse universiteti, punëdhënësi, nëse ka;

d) Certifikata për kualifikimet apo specializimet, të lëshuara nga organet përkatëse, në rast se ka;

dh) Dy fotografi dokumenti;

e) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale.

4. Certifikata e lejes profesionale si projektues, konsulent, kolaudues për aktivitetin e transportimit, depozitimit dhe tregtimit të lëndëve hidrokarbure

Aplikuesi, për këtë certifikatë, duhet të paraqesë në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet dokumentet e mëposhtme:

a) Kërkesën për kategorinë e certifikatës;

b) Fotokopje të noterizuar të diplomës universitare ose pasuniversitare dhe listës së notave. Aplikuesi duhet të jetë i diplomuar si inxhinier kimist teknolog nafte, inxhinier mekanik industri, inxhinier elektrik industri, inxhinier burime energjetike, fizikan, informaticien, matematicien dhe/ose inxhinier përpunimi kompjuterik të informacionit, ekonomist energjetik, inxhinier mjedisi për energjetikë. Për këtë certifikatë të lejes profesionale pranohet niveli master i studimeve universitare, në përputhje me ligjin e arsimit të lartë;

c) Fotokopje të noterizuar të librezës së punës, ku vërtetohet se ka një eksperiencë jo më pak se 5 (pesë) vjet në fushën e veprimtarisë së transportimit, depozitimit dhe tregtimit të lëndëve hidrokarbure;

ç) Një përshkrim të aktivitetit të tij studimor dhe projektues në fushën e transportimit, depozitimit dhe tregtimit të lëndëve hidrokarbure nga marrja e diplomës deri në momentin e kërkesës, në formë autobiografie teknike (*Curriculum-Vitae*), vërtetuar sipas dokumentacionit nga institucionet përkatëse,

punëdhënësi;

d) Referenca nga vetë aplikuesi apo persona fizikë/juridikë për objekte të studiuara, projektuara /zbatuara, në jo më pak se 2 (dy) të tilla;

dh) Certifikata për kualifikimet apo specializimet dhe kontributet e veçanta, të lëshuara nga organet përkatëse, në rast se ka;

e) Jo më pak se 2 (dy) referenca vlerësuese të aktivitetit të tij në fushën e transportimit, depozitimit dhe tregtimit të lëndëve hidrokarbure;

ë) Dy fotografi në format dokumenti;

f) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale.

5. Certifikata e lejes profesionale si drejtues teknik për aktivitetin e përpunimit, transportimit, depozitimit dhe tregtimit të lëndëve hidrokarbure

Aplikuesi, për këtë certifikatë, duhet të paraqesë në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet

a) Kërkesën për kategorinë e certifikatës;

b) Fotokopje të noterizuar të diplomës universitare ose pasuniversitare dhe listës së notave. Aplikuesi duhet të jetë i diplomuar si inxhinier kimist teknolog naftë, inxhinier mekanik industri, inxhinier elektrik industri, inxhinier burime energjetike, fizikan, informaticien, matematicien dhe/ose inxhinier përpunimi kompjuterik të informacionit, ekonomist energjetik, inxhinier mjedisi për energjetikë. Për këtë certifikatë të lejes profesionale pranohet niveli master i studimeve universitare, në përputhje me ligjin e arsimit të lartë;

c) Fotokopje të noterizuar të librezës së punës, ku vërtetohet se ka një eksperiencë jo më pak se 5 (pesë) vjet në fushën e veprimtarisë së përpunimit, transportimit, depozitimit dhe tregtimit të burimeve hidrokarbure;

ç) Një përshkrim të aktivitetit të tij në fushën e përpunimit, transportimit, depozitimit dhe tregtimit të lëndëve hidrokarbure nga marrja e diplomës deri në momentin e kërkesës, në formë autobiografie teknike (*Curriculum-Vitae*), vërtetuar sipas dokumentacionit nga institucionet përkatëse, punëdhënësi;

d) Referenca nga vetë aplikuesi apo persona fizikë/juridikë për kryerje dhe/ose zbatim projektesh të veprimtarive të përpunimit, transportimit, depozitimit dhe tregtimit të lëndëve hidrokarbure;

dh) Certifikata për kualifikimet apo specializimet dhe kontributet e veçanta, të lëshuara nga organet përkatëse, në rast se ka;

e) Jo më pak se 2 (dy) referenca vlerësuese të aktivitetit të tij në fushën e përpunimit, transportimit, depozitimit dhe tregtimit të lëndëve hidrokarbure;

ë) Dy fotografi në format dokumenti;

f) Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale.

C. Një individ mund të jetë zotërues i më shumë se një certifikate të lejes profesionale ose të ketë të përshkruara në certifikatën e lejes profesionale të tij disa nga kategoritë e shkronjave A dhe B, të përmendura më sipër.

Ç. Kur një person humbet certifikatën e lejes profesionale, njofton menjëherë zyrtarisht në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet. Subjekti pajiset me dublikatë, në bazë të kërkesës së tij të shoqëruar me fotokopjen e kartës së identitetit dhe diplomës, pas verifikimit të kopjes origjinale të certifikatës së lejes profesionale, depozituar në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet.

D. Elementet e certifikatës së lejes profesionale për veprimtarinë studiuese-projektuese dhe zbatuese në fushat e sektorit të lëndëve hidrokarbure janë:

a) Numri i regjistrimit themeltar dhe data;

- b) Të dhënat personale të subjektit (emër, mbiemër, atësi, datëlindje, vendbanim dhe fotografi);
- c) Data dhe titulli i diplomimit universitar dhe/ose pasuniversitar;
- ç) Fushën e veprimtarisë hidrokarbure për të cilën jepet certifikata.

DH. Dokumentet vërtetuese duhet të jenë të përpiluara në gjuhën shqipe, origjinale ose fotokopje të noterizuara. Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe nënshkrimi i përkthyesit të jetë i konfirmuar nga noteri.

ANEKSI 2

Përbërja e komisionit dhe procedurat e vlerësimit të dokumenteve për dhënien e certifikatës së lejes profesionale për kryerjen e veprimtarisë studimore-projektuese dhe zbatuese në fushat e sektorit të lëndëve hidrokarbure janë, si më poshtë vijon:

1. Komisioni i vlerësimit të dokumenteve vërtetuese për dhënien e certifikatës së lejes profesionale për kryerjen e veprimtarisë studimore-projektuese dhe zbatuese në fushat e sektorit të lëndëve hidrokarbure, ngrihet me urdhër të ministrit përgjegjës për hidrokarburet. Komisioni i vlerësimit përbëhet nga kryetari i komisionit, 10 (dhjetë) anëtarë dhe një sekretar (pa të drejtë vote). Anëtarë të komisionit caktohen, përkatësisht:

- 4 (katër) ekspertë nga ministria përgjegjëse për hidrokarburet;
- 1 (një) ekspert nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore;
- 1 (një) ekspert nga Inspektorati Shtetëror Përgjegjës pranë ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet;
- 1 (një) ekspert nga Universiteti Politeknik i Tiranës;
- 1 (një) ekspert nga Universiteti i Tiranës;
- 2 (dy) ekspertë hidrokarbur.

2. Komisioni funksionon pranë ministrisë përgjegjëse për hidrokarburet. Ai mbledhet çdo dy muaj, ndërmjet datave 25-30, dhe shqyrton kërkesat e paraqitura. Materiali që do të shqyrtohet në mbledhjen e radhës të komisionit përgatitet, nënshkruhet dhe u shpërndahet me postë dhe/ose në mënyrë elektronike, nga sekretari, anëtarëve të Komisionit, të paktën 2 (dy) ditë përpara zhvillimit të mbledhjes.

3. Në mbledhjen e radhës, komisioni shqyrton dhe vlerëson dokumentacionin e paraqitur në kërkesat gjatë periudhës dymujore dhe merr vendim për dhënien ose jo të certifikatës. Në rast se kërkesa nuk miratohet, aplikuesit i kthehet përgjigje me shkresë, duke i dhënë edhe sqarimet përkatëse.

4. Mbledhjet e komisionit janë të vlefshme kur në to marrin pjesë më shumë se 2/3 e anëtarëve të tij, por domosdoshmërisht me praninë e kryetarit të komisionit të vlerësimit. Sekretari mban procesverbalin e mbledhjes, i cili nënshkruhet nga vetë sekretari dhe anëtarët e komisionit që kanë qenë të pranishëm në mbledhje.

5. Vendimet në komisionin e vlerësimit merren me shumicën e votave të anëtarëve pjesëmarrës në votim. Në rast të votave të barabarta, vota e kryetarit është përcaktuese.

6. Sekretari, bazuar në vendimin e komisionit të vlerësimit, përgatit procesverbalin e mbledhjes së këtij komisioni, i cili firmoset nga anëtarët e pranishëm në mbledhje, si dhe përgatit certifikatën e lejes profesionale në 2 (dy) kopje origjinale, të cilat, pasi konfirmohen nga kryetari i komisionit të vlerësimit, përcillen për t'u nënshkruar nga ministri përgjegjës për hidrokarburet. Një kopje origjinale e certifikatës së lejes profesionale, i dorëzohet kërkuarit e vultur, ndërsa kopja tjetër, së bashku me dokumentacionin e paraqitur nga specialisti, dorëzohet nga sekretari i komisionit të vlerësimit, për ruajtje, në zyrën e protokollit.

7. Sekretari mban Regjistrin themeltar të kërkesave dhe certifikatave të lejeve profesionale të dhëna, i cili është një dokument i sekretuar sipas rregullave të arkivit së ministrisë.

